**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosova**
*Qeveria - Vlada – Government*
*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit

# Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosova**
*Qeveria - Vlada – Government*
*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit

# Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007



Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)
Data e botimit: Korrik  2009
© : Enti i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së
në internet:  www.ks-gov.net/esk

# P a r a th ë n i e

Kjo është anketa e shtatë me radhë e ekonomive shtëpiake bujqësore të cilën e realizon Enti i Statistikës së Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit.

Qëllimi i kësaj ankete është që të sigurohen të dhëna statistikore për sektorin e bujqësisë në Kosovë.

Rezultatet e Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007 të prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm të informatave mbi gjendjen e tanishme të bujqësisë në Kosovë (për periudhën referuese të anketës).

Përmirësime eventuale në qëndrueshmërinë e të dhënave mund të ketë pas regjistrimit të përgjithshëm të bujqësisë.

**Falënderimi**

ESK falënderon SIDA-në për mbështetjen që i ka dhënë për realizimin e kësaj ankete.
Falënderojmë në veçanti eksperten: Znj.Gillian Green për kontributin e veçantë për realizimin e kësaj ankete dhe përgatitjen e këtij publikimi.

Ky publikim është i përgatitur nga personeli i Departamentit të Statistikave të Bujqësisë dhe Ambientit në ESK :

Bajrush Qevani-Drejtor i Departamentit,
Haki Kurti-Shef i Divizionit,
Rexhep Fejzullahu-Zyrtar i lartë
Selami Zylfijaj- Zyrtar i lartë,
Hasime Bytyqi- Zyrtare e lartë
Dizajni: Ahmet Cakolli

ESK, gjithashtu falënderon të gjithë zyrtarët e zyrave rajonale të ESK-s, anketuesit dhe respondentët në terren për bashkëpunim dhe kontributin e dhënë.

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura.

Korrik, 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,
Avni Kastrati

## Lista e shkurtesave

| | |
|---|---|
| AESHB | Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore |
| BE | Bashkimi Evropian |
| ESH | Ekonomi Shtëpiake |
| ESK | Enti i Statistikës së Kosovës |
| RRDHKF | Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitetin e Fermave (FADN) |
| MBPZHR | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural |
| NPSH | Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore |
| NVP | Njësia Vjetore Punuese |
| PPM | Probabiliteti Proporcional sipas Madhësisë |
| NPM | Njësia Primare Mostrore (Primary Sample Unit - PSU) |

## Simbolet

| | |
|---|---|
| - | Nuk ka dukuri |
| : | Mungojnë të dhënat |
| . | Të pa aplikueshme |
| 0 | E dhëna është më e vogël se gjysmë njësie e përdorur |
| ha | Hektarë |
| kg | Kilogram |
| t | Ton |
| kf | Kalë-fuqi |
| % | Përqindje |

Në tabelat ku janë rrumbullaksuar shifrat deri në shifrën e fundit më të afërt, mund të ketë mospërputhje të lehtë të shumave të prezantuara.

# Përmbajtja


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Kapitulli 1 | Objektivat, metodologjija dhe shtrirja e anketës | 5 |
| Kapitulli 2 | Ekonomitë shtëpiake | 15 |
| Kapitulli 3 | Shfrytëzimi i tokës dhe struktura e fermës | 19 |
| Kapitulli 4 | Kulturat bujqësore | 25 |
| Kapitulli 5 | Pylltaria | 34 |
| Kapitulli 6 | Blegtoria | 36 |
| Kapitulli 7 | Inputet bujqësore | 39 |
| Kapitulli 8 | Fuqia punëtore në bujqësi | 42 |
| Kapitulli 9 | Shpenzimet e fermës | 45 |
| Kapitulli 10 | Krahasime ndërkombëtare | 47 |
| Aneksi 1 | Lista e komunave sipas rajoneve | 49 |
| Aneksi 2 | Pyetësori | 50 |

# 1. Objektivat, metodologjia dhe fushëveprimi i anketës

## 1.1. Objektivat dhe fushëveprimi i anketës

Objektivë e Anketës së Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007 është që të ofroj të dhëna mbi gjendjen bujqësore në Kosovë, d.m.th: demografinë e ekonomive shtëpiake bujqësore, shfrytëzimin e tokës dhe strukturën e fermës, blegtorinë, kulturat bujqësore, pylltarinë, inputet bujqësore, fuqinë punëtore dhe shpenzimet e fermës. Anketa synon që të ndihmoj llogaritjen e nivelit të zhvillimit të sektorit bujqësor në Kosovë dhe të ofroj bazat për monitorimin e ardhshëm të trendëve në këtë sektor.

Anketa hulumton (grumbullon të dhëna) për tokën e punuar nga ekonomitë shtëpiake bujqësore, blegtorinë dhe kultivimin e kulturave bujqësore në viset rurale[1]. Nuk përfshinë tokën që është pronë e ekonomive shtëpiake bujqësore në viset rurale e cila nuk është punuar, si dhe tokën e ekonomive shtëpiake bujqësore që jetojnë në viset urbane të Kosovës ose jashtë saj, vetëm nëse janë dhënë me qira ekonomive shtëpiake bujqësore nga viset rurale. Përveç kësaj në këtë anketë nuk është përfshirë toka, pronësi e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore. Toka e ndërmarrjeve bujqësore shtetërore e marrur me qira ose në ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit nga ekonomitë shtëpiake bujqësore është përfshirë në anketë.

Të dhënat janë paraqitur në nivel të Kosovës dhe atë rajonal, dhe në disa raste në nivel komunal. Të dhënat në nivel të Kosovës dhe në atë rajonal janë më të qëndrueshme sesa ato në nivel komunal, pasi që në disa komuna numri i ekonomive shtëpiake të intervistuara në çdo shtresë, është i vogël. Sidoqoftë të dhënat në nivel komunal janë paraqitur në disa kapituj, me qëllim që të ofrojnë detajet e kërkuara nga shfrytëzuesit e tyre. Aneksi 1 Rajonet e ESK-së dhe komunat që i mbulojnë këto rajone.

Anketa është kryer në nëntor dhe dhjetor të vitit 2007. Kjo anketë kryhet për çdo vit që nga viti 2001. Të gjitha fermat e mëdha, regjistrin e të cilave ESK e ka pasur në dispozicion, janë anketuar.

## 1.2. Korniza e anketës

Në fund të gushtit dhe shtatorit 2004 janë vizituar të gjitha fshatrat rurale në Kosovë. Janë vizituar 1414 fshatra.

Në bazë të intervistës ballë-për-ballë me krerët e fshatrave, janë marrë të dhënat për qëllim të azhurnimit të kornizës së mostrës. Në çdo fshat, nga kreu u fshatit janë marrë të dhënat për:

Numrin gjithsej të ekonomive shtëpiake në fshat;
Numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore në fshat;
Numrin e familjeve që aktualisht jetojnë në fshat;
Numrin e familjeve të fshatit që jetojnë jashtë fshatit;
Numrin gjithsej të banorëve të fshatit;
Numrin e banorëve që aktualisht jetojnë në fshat;
Numrin e banorëve të fshatit që jetojnë jashtë fshatit.

Kjo kornizë (regjistër) e të gjitha fshatrave në Kosovë është përdorur për të zgjedhur fshatrat me metodë të rastit (random) që do të përfshihen në anketë dhe për të përfunduar regjistrin derë-më-derë – fillimi i ndërtimit të regjistrit të fermave.

Duke filluar në vjeshtë të vitit 2004 dhe duke vazhduar në vjeshtë të vitit 2005, për 426 fshatra janë marrur të dhënat derë-më-derë dhe çdo ekonomi shtëpiake e vizituar është pyetur lidhur

[1] Së paku një anëtar i ekonomive shtëpiake bujqësore duhet të punoj tokën.

me tokën që kanë në pronësi, tokën e kultivuar, përdorimin e tokës, numrin e kafshëve sipas kategorive, si dhe nëse pronari ose dikush tjetër është duke punuar tokën.

Në vjeshtën e vitit 2005, të gjitha të dhënat (një ekonomi shtëpiake për rresht) për 426 fshatrat janë futur në bazën e të dhënave në ESK. Janë futur të dhëna përafërsisht për 67.000 ekonomi shtëpiake.

Vetëm ato ekonomi shtëpiake në këtë regjistër që plotësojnë definicionin e ekonomisë shtëpiake bujqësore brenda Kosovës dhe vetëm ato që ishin aktive në kultivim (e jo jashtë vendit) janë llogaritur si ekonomi shtëpiake bujqësore. Njëzet e një për qind e ekonomive shtëpiake bujqësore të futura në regjistër nga këto 426 fshatra nuk u kualifikuan sipas definicionit të ekonomive shtëpiake bujqësore, duke rezultuar në zbritje prej 21% të numrit të ekonomive shtëpiake. Pas zvogëlimit të numrit, mbetën afro 52.700 ekonomi shtëpiake bujqësore në 426 fshatrat e futura në listë.

Në vjeshtën e vitit 2007, ESK e zgjeroi kornizën e mostrës duke i listuar 175 PSU të reja në tërë Kosovën, nga 25 PSU për secilin rajon (në shtatë rajone). Këto 175 PSU mbuluan 156 fshatra të Kosovës.
Listimi i 175 PSU konsistoi me të dhëna për 23.882 ekonomi shtëpiake prej të cilave 6.301 sipas definicionit për ekonomitë shtëpiake bujqësore nuk ishin bujqësore, ose disa prej ekonomive shtëpiake e përmbushnin kriterin por pronaret e tyre ishin jashtë vendit. Si rezultat i kësaj pas heqjes se këtyre ESH jo bujqësore mbeten 17.581 ekonomi shtëpiake bujqësore.
Në total ESK ka kornizën – regjistrin për 90.882 ekonomi shtëpiake prej te cilave 70.281 janë bujqësore. Kjo kornizë – regjistër përmban informacione lidhur me tokën që kanë në pronësi, tokën e kultivuar, përdorimin e tokës, numrin e kafshëve sipas kategorive, si dhe nëse pronari ose dikush tjetër është duke punuar tokën.
Tentativat janë që ky regjistër të zgjerohet në vitet e ardhshme.
Mostra e anketës së ekonomive shtëpiake bujqësore 2007 është zgjedhur 50 % nga regjistri i krijuar në vitin 2004 dhe 50 % nga regjistri i ri i krijuar nga listimi i vitit 2007.

**Tabela: 1.1: Zgjerimi i ri i kornizës së anketës në vitin 2007**

| Shtresat e madhësisë në ha | Prishtina | Mitrovica | Peja | Gjakova | Prizreni | Ferizaji | Gjilani | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 - 1.5 ha | 1272 | 1313 | 1511 | 1297 | 1943 | 2583 | 2384 | 12303 |
| 1.51 - 3 ha | 416 | 607 | 552 | 494 | 445 | 488 | 474 | 3476 |
| 3.01+ ha | 221 | 250 | 310 | 284 | 193 | 221 | 219 | 1698 |
| Fermat e mëdha dhe të specializuara | 20 | 37 | 10 | 7 | 10 | 6 | 14 | 104 |
| Gjithsej | 1929 | 2207 | 2383 | 2082 | 2591 | 3298 | 3091 | 17581 |

### 1.3. Dizajnimi i mostrës

Anketa është bazuar në mostrën dy shtresore. Niveli i parë i shtresimit është bërë për nga rajoni me qëllim që të merren llogaritjet rajonale dhe për të siguruar shtrirjen e plotë gjeografike. Niveli i dytë i shtresimit ishte për nga madhësia e fermës për të siguruar përfaqësimin e ekonomive shtëpiake bujqësore. Nëse një fshat është zgjedhur për t'u përfshirë në anketën 2007, ekonomitë shtëpiake në fshat janë shtresuar në tri kategori të madhësisë (duke shfrytëzuar tokën e kultivuar si vlerë të shtresimit): 0-1.5 ha, 1.51-3 ha, dhe mbi 3 ha. Pas shtresimit, ekonomitë shtëpiake për intervistë janë zgjedhur me metodë të rastit.

Tabela 1.2 dhe 1.3 tregojnë numrat e ekonomive shtëpiake bujqësore të intervistuara në anketën e vitit 2007 në çdo shtresë madhësie sipas rajoneve dhe komunave. Madhësia e mostrës (numri total i ekonomive shtëpiake të intervistuara) ishte 4.136.

**Tabela 1.2: Numri i ekonomive shtëpiake të intervistuara sipas madhësisë së fermës dhe rajoneve**

| Madhësia e fermës | Prishtina | Mitrovica | Peja | Gjakova | Prizreni | Ferizaji | Gjilani | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0 - 1.5 ha | 297 | 261 | 243 | 259 | 272 | 285 | 268 | 1.885 |
| 1.51 - 3 ha | 173 | 188 | 214 | 200 | 164 | 166 | 215 | 1.320 |
| 3.01 + ha | 114 | 114 | 137 | 129 | 120 | 127 | 86 | 827 |
| Fermat e mëdha dhe të specializuara bujqësore | 12 | 9 | 27 | 11 | 29 | 4 | 12 | 104 |
| Gjithsej | 596 | 572 | 621 | 599 | 585 | 582 | 581 | 4.136 |

**Tabela 1.3: Numri i ekonomive shtëpiake të intervistuara, sipas madhësisë së fermës në komuna**

| Komunat | 0 - 1.5 ha | 1.51 - 3 ha | 3.01 + ha | Fermat e mëdha dhe të specializuara | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kosova** | 1885 | 1320 | 827 | 104 | 4136 |
| Deçani | 84 | 49 | 32 | 2 | 167 |
| Gjakova | 99 | 79 | 46 | 5 | 229 |
| Gllogovci | 74 | 53 | 33 | 1 | 161 |
| Gjilani | 118 | 105 | 35 | 6 | 264 |
| Dragashi | 40 | 43 | 38 | 11 | 132 |
| Istogu | 63 | 55 | 37 | 12 | 167 |
| Kaçaniku | 66 | 31 | 23 | 1 | 121 |
| Klina | 48 | 52 | 43 | 4 | 147 |
| F.Kosova | 35 | 17 | 9 | 0 | 61 |
| Kamenica | 75 | 49 | 25 | 2 | 151 |
| Mitrovica | 51 | 25 | 16 | 2 | 94 |
| Leposaviqi | 22 | 1 | 0 | 0 | 23 |
| Lipjani | 41 | 26 | 10 | 4 | 81 |
| N.Bërda | 2 | 3 | 6 | 0 | 11 |
| Obiliqi | 14 | 7 | 9 | 1 | 31 |
| Rahoveci | 76 | 72 | 51 | 4 | 203 |
| Peja | 132 | 107 | 57 | 11 | 307 |
| Podujeva | 77 | 36 | 23 | 3 | 139 |
| Prishtina | 54 | 31 | 24 | 3 | 112 |
| Prizreni | 95 | 37 | 26 | 15 | 173 |
| Skenderaj | 90 | 76 | 39 | 1 | 206 |
| Shtimja | 50 | 35 | 36 | 0 | 121 |
| Shtërpca | 22 | 7 | 1 | 0 | 30 |
| Suhareka | 81 | 46 | 23 | 1 | 151 |
| Ferizaji | 147 | 93 | 67 | 3 | 310 |
| Vitia | 75 | 61 | 26 | 4 | 166 |
| Vushtrria | 78 | 70 | 41 | 5 | 194 |
| Z.Potoku | 3 | 10 | 17 | 1 | 31 |
| Zveçani | 17 | 6 | 1 | 0 | 24 |
| Malisheva | 56 | 38 | 33 | 2 | 129 |

Për të zvogëluar heterogjenitetin e kornizës mostër dhe për të përmirësuar llogaritjet, të gjitha fermat që ishin mbi shpërndarjen normale, në kuptim të madhësisë së fermës ose numrit të kafshëve, u identifikuan dhe të gjitha u anketuan. Këto janë quajtur 'ferma të mëdha dhe të specializuara'. Kufijtë për fermat e mëdha dhe të specializuara janë caktuar në vitin 2004.

Tabela 1.4 paraqet kufijtë e përdorur për zgjedhjen e fermave të mëdha dhe të specializuara.

**Tabela 1.4: Kufijtë për fermat e mëdha dhe të specializuara sipas llojit**

| Prodhimi | Kufiri i zgjedhur |
|---|---:|
| Patate | 10 ha |
| Drithëra | 50 ha |
| Kulturat industriale | Të gjitha fermat |
| Pemishte | 1.5 ha |
| Vreshta | 4 ha |
| Hortikultura (hapur) | 3 ha |
| Hortikultura (mbyllur) | 0.30 ha |
| Gjedhë | 35 |
| Dele | 200 |
| Dhi | 40 |
| Derra | 35 |
| Shpezë | 4000 |

Në mungesë të regjistrit komplet të fermave, është përpiluar një listë e të gjitha fermave në Kosovë mbi kufijtë e madhësisë. Kjo është arritur përmes referimit në të dhënat ekzistuese, dhe u identifikuan dhe anketuan 104 ferma të mëdha dhe të specializuara. Në këtë publikim ato janë emërtuar si “ferma të mëdha dhe të specializuara”. Ato nuk janë doemos ferma komerciale. Të gjitha ekonomitë tjera shtëpiake bujqësore në kapitujt e mëposhtëm janë quajtur “ekonomi të vogla shtëpiake bujqësore ose ferma”.

## 1.4 Procedura e llogaritjes

Qëllimi i mbajtjes së anketës është sigurimi i informatave rreth populacionit, në këtë rast ekonomive shtëpiake bujqësore në Kosovë. Kur është zgjedhur mostra (e cila është nëngrup i populacionit të analizuar) dhe kur të dhënat janë grumbulluar dhe përpunuar, ende mbetet detyra e lidhjes së informatave të grumbulluara nga mostra – dhe populacionit. Kjo do të thotë se është intervistuar një mostër e ekonomive shtëpiake bujqësore (4.136 në mostrën e këtij viti), dhe nga përgjigjet dhe informatat e dhëna nga ekonomitë shtëpiake në mostër, duhet të bëhen llogaritjet e tërë populacionit, do të thotë të gjitha ekonomive shtëpiake bujqësore në Kosovë.

Procesi i llogaritjes mbështetet nga pesha e mostrimit të njësisë (në këtë rast njësia është një ekonomi shtëpiake bujqësore) që tregon numrin e njësive në populacion të cilat janë përfaqësuar nga kjo njësi e mostruar. Do të thotë për çdo ekonomi shtëpiake bujqësore të intervistuar, sa ekonomi shtëpiake bujqësore përfaqëson kjo ekonomi shtëpiake e intervistuar. Numri i ekonomive shtëpiake të cilat i përfaqëson një ekonomi shtëpiake e mostruar është pesha e saj.

**Kutia 1. Një shembull i thjeshtë i peshës së anketës**

Të supozojmë se e kemi një fshat me 60 ekonomi shtëpiake bujqësore. Vendosim që të zgjedhim sipas rastit 5 ekonomi shtëpiake për t'i intervistuar dhe informatat e marra nga intervistat do t'i përdorim për të llogaritur variablat e caktuara për fshatin – të themi do të llogarisim zonën e kultivuar me grurë dhe numrin e lopëve në fshat.

Këto janë rezultatet e intervistave nga 5 ekonomi shtëpiake:

| Numri i ekonomisë Shtëpiake | Sipërfaqja (ha) e kultivuar me grurë | Numri i lopëve | Pesha e mostrimit |
|---|---|---|---|
| 1 | 1.0 | 0 | 12 |
| 2 | 0.44 | 2 | 12 |
| 3 | 0.20 | 1 | 12 |
| 4 | 0.85 | 3 | 12 |
| 5 | 0 | 2 | 12 |

Pesha e mostrimit për çdo ekonomi shtëpiake është 12 sepse janë 60 ekonomi shtëpiake në fshat, dhe ne kemi zgjedhur 5 nga to për t'i intervistuar, kështu që çdo ekonomi shtëpiake përfaqëson 60/5= 12 ekonomi shtëpiake.

Për të llogaritur numrin e lopëve në fshat, shumëzojmë vlerën e secilës ekonomi shtëpiake me peshën për atë ekonomi shtëpiake (12). Kështu llogaria për numrin total të kafshëve në fshat është
(0*12)+ (2*12)+(1*12)+(3*12)+ (2*12)=96 lopë.

Njëjtë për sipërfaqen e kultivuar me grurë, kalkulimi do të jetë
(1.0*12)+(0.44*12)+(0.20*12)+(0.85*12)+(0*12)=12+5.28+2.4+10.2+0=29.88 ha.

Natyrisht se disa ekonomi shtëpiake të intervistuara nuk do të japin llogaritje të besueshme për atë fshat, por ky shembull ilustron se si përdoren peshat. Në këtë rast ne nuk kemi shtresuar ekonomitë shtëpiake në asnjë mënyrë, do të mund të merrnim llogaritje më të mira nëse do të mund të gruponim ekonomitë shtëpiake bujqësore në grupe që korrespondojnë në sipërfaqen e tokës së kultivuar nga çdo ekonomi shtëpiake, e më pas të kalkulohen peshat për çdo grupim të madhësisë.

Është përgjegjësi e mostruesit për të përcaktuar planin e mostrimit që siguron intervistimin e njësive të mjaftueshme për të dhënë llogaritje të besueshme.

Në shembullin e caktimit të peshës në Kutinë 1, shihet se janë 60 ekonomi shtëpiake në fshat prandaj janë zgjedhur 5 ekonomi shtëpiake për intervistë, është e qartë se çdo ekonomi shtëpiake e intervistuar ka peshën 12.

**Vështirësitë për të definuar peshën e anketës në Kosovë**

Sfida në Kosovë është se nuk dihet numri i përgjithshëm i ekonomive shtëpiake bujqësore, prandaj është vështirë të caktohet pesha për të shumëzuar ekonomitë shtëpiake të mostruara për të pasur shifra në nivel rajonal apo në nivel vendi. Kjo vështirësi do të mbetet deri sa të realizohet regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë ose i bujqësisë. Regjistrimi duhet të themeloj një kornizë të mostrës nga e cila do të mund të kalkulohen peshat e besueshme për të gjitha anketat në bujqësi. Alternativë tjetër është edhe kompletimi i regjistrit ekzistues të fermave i krijuar gjatë vitit 2004, 2005 dhe 2007, që do të mund të shfrytëzohej si kornizë për anketat bujqësore.

**Kalkulimi i peshave për anketën e ekonomive shtëpiake 2007**

Kjo anketë ka përdorur metodologjinë e njëjtë si në vitin 2006, megjithatë ka pranuar faktin se do të mund të ketë rritje në Kosovë që nga viti 2004 kur është krijuar ky regjistër i fermave. Në vitin 2005 duke shfrytëzuar regjistrin e ekonomive shtëpiake bujqësore të vitit 2004, vlerësimi i numrit të ekonomive shtëpiake për çdo rajon ishte 172.328, megjithatë kjo nuk ka marrë parasysh vlerësimin e rritjes në nivel vendi siç është bërë kur është aplikuar metodologjia për herë të parë. Vlerësimet origjinale për vitin 2004 ishin shumë të ulta (117.000), dhe nuk kanë mundur të shfrytëzohen si bazë për të predikuar shkallën e rritjes

Ekonomitë shtëpiake bujqësore u vlerësuan të jenë 178.800, kjo është një rritje prej 3.8% nga shifrat e viteve të kaluara 172.328. Së fundi kjo shifër nuk merr parasysh ndonjë rritje mes viteve 2004 dhe 2005.

Po ashtu argumente tjera për të arsyetuar shifrën prej 3.8% për rritjen në nivel vendi të ekonomive shtëpiake bujqësore, janë kontaktuar të gjitha (shtatë) zyrat rajonale të ESK-së; përgjigjet e tyre dhanë një vlerësim mesatar prej 6% të rritjes vjetore të ekonomive shtëpiake.

Vlerësimet për vitin 2005 dhe për vitin 2004, si vlerësim i 172.328 ka pasur 0 rritje, shifrat për vitin 2005, 2006 dhe 2007 janë vlerësuar duke përdorur shkallën e rritjes vjetore prej 6%.

**Vlerësimi i numrit të ekonomive shtëpiake bujqësore në vitin 2007 duke shfrytëzuar metodologjinë e përshtatur të vitit 2006 me aplikimin e shkallës vjetore te rritjes 6 %.**

Pasi që në vitin 2005 nuk kishte numër definitiv të ekonomive shtëpiake bujqësore, është dashur të bëhet një vlerësim.
Të dhënat e kufizuara të cilat ne i kemi pasur na kanë dhënë numrin e ekonomive familjare bujqësore brenda fshatit në regjistrin e fermave, dhe gjithsej numrin e fshatrave në rajone. Supozimet janë bërë që fshatrat në rajone do të ndjekin shpërndarjen e njëjtë ashtu që ne do të mund ti shumëzonim numrin e fermave të dhëna në shtresa sipas numrit të fshatrave. Për ta bërë këtë më të qartë janë dhënë shpjegimet vijuese.

Tabelat e mëposhtme ilustrojnë tre hapat e përdorur për të kalkuluar peshat për anketën e vitit 2007 (dhe shërbejnë si shembull se si peshat kalkulohen në përgjithësi për anketa).
Hapi 1: Kalkulimi i faktorëve shumëzues – numri i fshatrave të përfshira në Regjistrin e Fermave në raport me numrin e përgjithshëm të fshatrave në çdo rajon.

Tabela 1.5 tregon numrin e fshatrave të regjistruara (kolona a) krahasuar me numrin e përgjithshëm të fshatrave në atë rajon të Kosovës (kolona b). Bazuar në këto shifra, faktori shumëzues nga këto vlera për çdo rajon është kalkuluar duke shfrytëzuar:
$MF = b / a$
Ku MF është faktori shumëzues; b është numri total i fshatrave, dhe; a është numri i fshatrave në regjistrin e fermave.

**Tabela 1.5: Kalkulimi i faktorit shumëzues**

| Rajonet | a<br>Nr. fshatrave në regjistrin e fermave(2004+2007) | b<br>Nr. gjithsej i fshatrave * | MF=b/a<br>Faktori shumëzues |
|---|---|---|---|
| Prishtina | 110 | 270 | 2.5 |
| Mitrovica | 109 | 317 | 2.9 |
| Peja | 79 | 180 | 2.3 |
| Gjakova | 69 | 155 | 2.2 |
| Prizreni | 85 | 193 | 2.3 |
| Ferizaji | 76 | 121 | 1.6 |
| Gjilani | 73 | 178 | 2.4 |
| Gjithsej | 601 | 1.414 | |

** Siç është regjistruar në bazën e të dhënave në ESK, të dhënat sipas krerëve të fshatit.*

**Hapi 2: Llogaritja e numrit total të ekonomive shtëpiake bujqësore për nga rajoni dhe madhësia e fermës.**

Numri total i ekonomive shtëpiake bujqësore në çdo rajon për nga madhësia e fermës është llogaritur duke aplikuar faktorin shumëzues (të paraqitur në tabelën 1.5) me numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore për çdo kategori të madhësisë, të përfshirë në regjistrin e fermave.

Tabela 1.6 tregon numrin total të ekonomive shtëpiake bujqësore në regjistrin e fermës, për nga rajoni dhe kategoria e madhësisë. Për çdo rajon, ekonomitë shtëpiake bujqësore janë ndarë në katër shtresa të kategorisë së madhësisë (tri shtresa të madhësisë dhe "shtresa e fermave të mëdha dhe të specializuara"). Me qëllim që të llogaritet numri total i ekonomive shtëpiake bujqësore në çdo kategori të madhësisë në çdo rajon, është përdorur faktori shumëzues (mf) dhe shkalla e rritjes (g) në numrin e ekonomive shtëpiake bujqësore të përfshira në regjistrin e fermave (c).

E = MF *((c2004 * g)+(c2007))
Ku E është llogaritja, MF është faktori shumëzues, c është numri i ekonomive shtëpiake bujqësore në shtresat relevante në regjistrin e fermave, g= 19.10 shkalla e rritjes në mes të vitit 2004 dhe 2007 ( 6 % në vit).

**Tabela 1.6: Llogaritja e numrit total të ekonomive shtëpiake bujqësore**

| E=MF*c*g | Prishtina | Mitrovica | Peja | Gjakova | Prizreni | Ferizaji | Gjilani | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0-1.50 ha c2004 | 9 | 4 | 4 | 4 | 7 | 5 | 4 | |
| 0-1.50 ha c2007 | 1.272 | 1.313 | 1.511 | 1.297 | 1.943 | 2.583 | 2.384 | |
| Llogaritja E | 31.064 | 18.217 | 13.704 | 12.493 | 23.058 | 13.423 | 17.815 | 129.774 |
| 1.51 - 3 ha c2004 | 3 | 2 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| 1.51 - 3 ha c2007 | 416 | 607 | 552 | 494 | 445 | 488 | 474 | |
| Llogaritja E | 10.223 | 7.200 | 5.064 | 4.616 | 1.355 | 2.961 | 4.971 | 36.390 |
| 3.01 + ha c2004 | 2 | 623 | 600 | 519 | 416 | 315 | 576 | |
| 3.01 + ha c2007 | 221 | 250 | 310 | 284 | 193 | 221 | 219 | |
| Llogaritja E | 5.090 | 2.877 | 2.357 | 1.985 | 1.583 | 954 | 2.172 | 17.018 |
| Fermat e mëdha dhe të specializuara 2004 | 4 | 11 | 12 | 9 | 27 | 12 | 29 | 104 |
| Fermat e mëdha dhe të specializuara 2007* | 20 | 37 | 10 | 7 | 10 | 6 | 14 | 104 |
| Gjithsej 2007 | 46.381 | 28.305 | 21.137 | 19.103 | 26.023 | 17.350 | 24.987 | 183.286 |
| Gjithsej | 46.381 | 28.305 | 21.137 | 19.103 | 26.023 | 17.350 | 24.987 | 183.286 |

***** *Nuk janë përfshirë në llogaritjen gjithsej të dhënat për fermat e mëdha dhe të specializuara derisa të vërtetohen gjatë anketimit të vitit 2008 dhe kjo anketë representon vetëm 183.286 ekonomi shtëpiake bujqësore*

Duke shfrytëzuar këtë metodë të kalkulimit të numrit total të ekonomive shtëpiake bujqësore në Kosovë, është llogaritur numri total prej 183.286 ekonomi shtëpiake bujqësore.
Dihet se vlerësimet në nivel vendi në bazë të kornizës së mostrës e cila përfshin me shumë se gjysmën e populacionit (në regjistër) dhe një të treten e populacionit jashtë regjistrit dhe e përshtatur me rritjen vjetore prej 6 % të bazuara në përgjigjet me telefon të marrura nga zyrat rajonale të ESK-së, mund të jenë vlerësime të anueshme.

Një çështje tjetër që anketa e tregon është kombinimi i dy anketave së bashku: asaj mbi kulturat bujqësore dhe blegtorinë. Fermat e vogla të Kosovës për nga madhësia (ekonomitë shtëpiake bujqësore) dhe definicioni i ekonomive shtëpiake bujqësore që nënkupton që fermat e vogla sipas tokës bujqësore (mbajnë peshën – ponderin më të lartë) mund të shfrytëzojnë tokën e shtetit – tokën publike për ta mbajtur blegtorinë. Kjo çështje e shtron nevojën e stratifikimit tjetër të mostrës për blegtorinë. Këto dhe shumë çështje tjera mund marrin përgjigje vetëm pas regjistrimit të popullsisë ose të bujqësisë.

Gjer sa të kryhet regjistrimi dhe të krijohet korniza e besueshme për numrin e ekonomive shtëpiake dhe ekonomive shtëpiake bujqësore, në Kosovë do të ketë debate rreth peshës së aplikuar pasi që peshat dalin direkt nga numri i supozuar i ekonomive shtëpiake bujqësore. Sidoqoftë çka është e qartë se në mungesë të regjistrimit të popullsisë dhe atij të bujqësisë nevojitet që të zgjerohet regjistri ekzistues i ekonomive shtëpiake bujqësore me qëllim që të lehtësoj vlerësimin me te saktë të ekonomive shtëpiake bujqësore në Kosovë. Ky zgjerim i regjistrit të ekonomive shtëpiake bujqësore duhet të vazhdoj derisa te kryhet regjistrimi i plotë i përgjithshëm i bujqësisë.

**Hapi 3: Kalkulimi i peshave**
Peshat për këtë anketë janë përcaktuar duke kalkuluar raportin e ekonomive shtëpiake bujqësore të intervistuara krahasuar me numrin total të llogaritur të ekonomive shtëpiake bujqësore në çdo rajon dhe shtresat siç është paraqitur në tabelën 1.6. Prandaj:
Ë = E / S

Ku Ë është pesha; S është madhësia e mostrës; dhe E është llogaritja e numrit total të ekonomive shtëpiake bujqësore.

Duke përcjellur këtë metodë, janë kalkuluar peshat për çdo shtresë të madhësisë dhe regjion për të përmirësuar besueshmërinë e llogaritjeve. Llogaritjet janë përmirësuar duke shfrytëzuar fermat në kategorinë e njëjtë të madhësisë dhe rajonin për të gjetur llogaritë për të gjitha fermat në këtë kategori dhe regjion të njëjtë. Tabela 1.7 tregon peshat që janë kalkuluar për çdo regjion dhe çdo shtresë (madhësi të fermës).

**Tabela 1.7: Peshat**

| W = E/S | Prishtina | Mitrovica | Peja | Gjakova | Prizreni | Ferizaji | Gjilani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 0-1.5 ha | 104.593 | 69.797 | 56.395 | 48.236 | 84.772 | 47.098 | 66.474 |
| 1.51 - 3 ha | 59.092 | 38.298 | 23.664 | 23.080 | 8.262 | 17.837 | 23.121 |
| 3.01 + ha | 44.649 | 25.237 | 17.204 | 15.388 | 13.192 | 7.512 | 25.256 |
| Fermat e mëdha dhe të specializuara | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 |

Kutia 2 jep një shembull se si këta tre hapa ndiqen në praktikë. Pasi që Kosova të ketë përfunduar regjistrin e fermave, hapat 1 dhe 2 nuk do të jenë më të domosdoshëm.

**Kutia 2. Një shembull se si kalkulohen peshat për anketë**

**Hapi 1.** Në Prishtinë janë 110 fshatra në regjistrin e fermës prej gjithsej 270 fshatrave. Prandaj faktori shumëzues do të jetë: 270 / 110 = 2.5.

**Hapi 2**. Në 110 fshatrat e Prishtinës, në regjistrin e fermave janë regjistruar 31,064 ekonomi shtëpiake bujqësore në kategorinë më të vogël të madhësisë prej 0 – 1.5 ha. Llogaritja e numrit të ekonomive shtëpiake bujqësore në të gjitha 270 fshatrat e Prishtinës për atë kategori të madhësisë kalkulohet duke shumëzuar 12425,72 me faktorin shumëzues 2.5.
Prandaj:

E = MF * c2004*g+c2007 =12425,72 *2.5 = 31.064 ose 9.365 * 1.191+1272 = 12.425,72 *2.5 = 31.064

c2004 = 9365
c2007 = 1272
g = 1.191
Duke ndjekur procedurën e njëjtë, llogaritja e numrit të fermave në kategorinë 1.5 – 3 ha është 10,223 ekonomi shtëpiake bujqësore dhe për fermat me mbi 3 ha është 5,090. Në Prishtinë janë intervistuar 12 ferma të mëdha dhe të specializuara. Këto ferma nuk kanë faktor shumëzues pasi që janë intervistuar të gjitha pasi që janë identifikuar, prandaj nuk përfaqësojnë ferma tjera.

**Hapi 3.** Në Prishtinë janë intervistuar gjithsej 596 ekonomi shtëpiake prej të cilave në kategorinë e madhësisë prej 0 – 1.5 ha, janë intervistuar 297. Pesha e aplikuar për fermat e intervistuara në Prishtinë në kategorinë e madhësisë së fermës 0 – 1.5 ha është 31.064 pjesëtuar me 297:

Ë = E / S ose 31.064/ 297 = 104,593

Pesha e aplikuar për ekonomitë shtëpiake bujqësore të kategorisë së madhësisë 0 – 1.5 ha në Prishtinë ishte 104,593.

### 1.5. Definicionet

Anketa është kryer duke përdorur këto definicione :
Ekonomi shtëpiake është një bashkësi e personave që jetojnë së bashku, grumbullojnë dhe shpenzojnë të ardhurat e tyre të përbashkëta.

Ekonomi shtëpiake bujqësore është ajo që posedon dhe kultivon më shumë se 0.10 ha të tokës së punueshme[2], ose më pak se 0.10 ha të tokës së punueshme por ka së paku:

1 lopë dhe një viç, ose 1 lopë dhe 1 mështjerrë,
1 lopë dhe 2 frymë dele ose dhi të rritura,
5 dele ose dhi të rritura,
4 dele të rritura dhe derra së bashku,
3 derra të rritur,
50 shpezë të rritura,
20 koshere bletësh,
mbi 20 m² hurdhë për peshq.

Sipërfaqja totale e tokës së ekonomisë shtëpiake përfshinë tërë tokën që është pronë e ekonomisë shtëpiake, e punuar ose jo, dhe e dhënë me qira. Ngastrat që fizikisht gjenden brenda pronës së ekonomisë shtëpiake të intervistuar por që janë dhënë me qira ose pa pagesë të tjerëve për ta punuar, gjithashtu përfshihen në sipërfaqen totale të ekonomisë shtëpiake. Si rrjedhojë, ka mundësi të numërimit të dyfishtë nëse edhe njerëzit që shfrytëzojnë këto ngastra përfshihen në mostrën e anketës. Duke pasur parasysh madhësinë relativisht të vogël të mostrës, probabiliteti i numërimit të dyfishtë është llogaritur të jetë i vogël.

### 1.6. Procedura në terren

Metodë e grumbullimit të të dhënave ishte intervista ballë-për-ballë me pyetësor (aneksi 2). Mbikëqyrësit fushor dhe regjional mbajtën mbikëqyrje të afërt fushore dhe kontakte me zyrën qendrore për të zgjidhur problemet që paraqiteshin.

Është kryer edhe procedura e kontrollimit të të dhënave. Ajo përbëhej nga tri nivele: (i) kontrollimi i pyetësorëve të plotësuar në fushë nga mbikëqyrësit fushor: (ii) kontrollimi i pyetësorëve në zyrën qendrore të ESK-së nga personeli i Departamentit të Bujqësisë dhe (iii) kontrollet logjike gjatë përfshirjes së të dhënave.

[2] Ara, kopshte, serra, pemishte, vreshta, livadhe.

## 2. Ekonomitë shtëpiake bujqësore

Ky kapitull përmban të dhënat për ekonomitë shtëpiake bujqësore në vitin 2007 lidhur me moshën, gjininë dhe arsimimin e anëtarëve të ekonomive shtëpiake. Duhet të cekët se janë numëruar vetëm ekonomitë shtëpiake që janë definuar si bujqësore në pajtim me definicionin e dhënë në kapitullin 1. Gjithashtu në këtë anketë janë përfshirë vetëm ekonomitë shtëpiake që jetojnë dhe punojnë tokën në fshatra. Tabela 2.1 tregon numrin gjithsej të popullsisë bujqësore sipas grup-moshës.

**Tabela 2.1 Popullsia bujqësore sipas grup-moshës**

| Grup-mosha | Numri | % | Kumulativi % |
|---|---|---|---|
| Gjer në 14 vjeç | 379.105 | 28,6 | 28,6 |
| 15 - 29 vjeç | 384.366 | 29,0 | 57,6 |
| 30 - 49 vjeç | 336.855 | 25,4 | 83,1 |
| 50 - 64 vjeç | 135.919 | 10,3 | 93,3 |
| 65 - e më tepër | 88.428 | 6,7 | 100,0 |
| Gjithsej | 1.324.673 | 100,0 | |

Tabela tregon popullsinë totale bujqësore për 1.324.673 banorë. Kosova karakterizohet me popullsi të re. Popullsia bujqësore e grup-moshës prej 15 gjer 29 vjeçare është 29 %. Ka numër të vogël të popullsisë mbi moshën 65 vjeçare, më saktësisht 6.7%.

**Grafiku 2.1: Madhësia e ekonomive shtëpiake bujqësore**




Grafiku 2.1 paraqet shpërndarjen e ekonomive shtëpiake bujqësore për nga madhësia. Ekonomitë shtëpiake bujqësore në Kosovë janë të mëdha. Shumica e ekonomive shtëpiake kanë 5-8 anëtarë, 57%. Numri mesatar i anëtarëve të ekonomive shtëpiake bujqësore është 7.2. Ekonomitë shtëpiake shumë të mëdha, me 16 e më shumë anëtarë, zënë 4 %.

**Tabela 2.2: Struktura e popullsisë bujqësore sipas grup-moshave në rajone**

| Rajonet | Grup mosha | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjer në 14 | | 15 - 29 | | 30 – 49 | | 50 - 64 | | 65 e mbi | | Gjithsej | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| **Kosova** | 379.105 | 28,6 | 384.366 | 29,0 | 336.855 | 25,4 | 135.919 | 10,3 | 88.428 | 6,7 | 1.324.673 | 100,0 |
| Prishtina | 96.636 | 28,9 | 96.761 | 28,9 | 85.861 | 25,6 | 34.388 | 10,3 | 21.208 | 6,3 | 334.854 | 100,0 |
| Mitrovica | 50.600 | 26,6 | 59.074 | 31,0 | 45.419 | 23,8 | 21.509 | 11,3 | 13.943 | 7,3 | 190.545 | 100,0 |
| Peja | 44.572 | 29,8 | 43.580 | 29,1 | 36.148 | 24,2 | 14.703 | 9,8 | 10.666 | 7,1 | 149.668 | 100,0 |
| Gjakova | 43.965 | 29,1 | 43.618 | 28,8 | 39.703 | 26,2 | 13.279 | 8,8 | 10.775 | 7,1 | 151.340 | 100,0 |
| Prizreni | 63.488 | 29,3 | 65.373 | 30,2 | 54.839 | 25,3 | 20.904 | 9,7 | 11.913 | 5,5 | 216.517 | 100,0 |
| Ferizaji | 35.605 | 28,5 | 35.560 | 28,4 | 32.299 | 25,8 | 13.777 | 11,0 | 7.826 | 6,3 | 125.068 | 100,0 |
| Gjilani | 44.240 | 28,2 | 40.400 | 25,8 | 42.586 | 27,2 | 17.360 | 11,1 | 12.097 | 7,7 | 156.682 | 100,0 |

Dallimet rajonale në strukturën e moshës së popullsisë bujqësore janë të vogla. Rajonet e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës kanë përqindje më të lartë të popullsisë së grup-moshës gjer në 14 vjeç. Mitrovica, Prizreni dhe Peja kanë përqindje më të lartë të popullsisë në grup-moshën prej 15 gjer në 29 vjeçare. Pjesa e grupit thelbësor të popullsisë punuese, në mes 30 dhe 49 vjeçare, është më e lartë në rajonet e Gjilanit, Gjakovës dhe Ferizajt. Rajonet e Mitrovicës, dhe Gjilanit kanë pjesën më të madhe të grupmoshave 50 gjer 64 vjeçare. Përqindje më të lartë të popullsisë mbi moshën 65 vjeçare kanë rajoni i Gjilanit dhe Mitrovicës.

**Tabela 2.3: Struktura e popullsisë bujqësore sipas grup moshave në komuna**

| Komunat | Grup-mosha | | | | | | | | | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjer në 14 | | 15 - 29 | | 30 - 49 | | 50 - 64 | | 65 e mbi | | | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| **Kosova** | 379.105 | 28,6 | 384.366 | 29,0 | 336.855 | 25,4 | 135.919 | 10,3 | 88.428 | 6,7 | 1.324.673 | 100,0 |
| Deçani | 7.917 | 22,9 | 10.612 | 30,7 | 8.734 | 25,2 | 4.402 | 12,7 | 2.928 | 8,5 | 34.593 | 100,0 |
| Gjakova | 17.323 | 29,9 | 16.187 | 28,0 | 14.951 | 25,8 | 4.941 | 8,5 | 4.463 | 7,7 | 57.864 | 100,0 |
| Gllogovci | 29.734 | 32,0 | 29.075 | 31,2 | 21.634 | 23,3 | 7.634 | 8,2 | 4.964 | 5,3 | 93.041 | 100,0 |
| Gjilani | 15.966 | 25,3 | 16.022 | 25,4 | 17.869 | 28,3 | 8.159 | 12,9 | 5.090 | 8,1 | 63.105 | 100,0 |
| Dragashi | 8.532 | 25,0 | 9.933 | 29,1 | 9.080 | 26,6 | 3.313 | 9,7 | 3.302 | 9,7 | 34.160 | 100,0 |
| Istogu | 11.799 | 30,4 | 10.837 | 27,9 | 9.328 | 24,0 | 3.618 | 9,3 | 3.252 | 8,4 | 38.834 | 100,0 |
| Kaçaniku | 7.235 | 25,8 | 8.783 | 31,3 | 7.209 | 25,7 | 3.120 | 11,1 | 1.704 | 6,1 | 28.051 | 100,0 |
| Klina | 12.525 | 32,0 | 12.081 | 30,8 | 9.222 | 23,5 | 3.411 | 8,7 | 1.955 | 5,0 | 39.194 | 100,0 |
| F.Kosova | 9.731 | 26,3 | 9.880 | 26,7 | 10.277 | 27,8 | 3.771 | 10,2 | 3.338 | 9,0 | 36.996 | 100,0 |
| Kamenica | 11.628 | 27,5 | 11.090 | 26,3 | 11.571 | 27,4 | 4.497 | 10,6 | 3.444 | 8,2 | 42.230 | 100,0 |
| Mitrovica | 10.429 | 29,3 | 11.275 | 31,7 | 7.652 | 21,5 | 3.872 | 10,9 | 2.382 | 6,7 | 35.610 | 100,0 |
| Leposaviqi | 558 | 8,7 | 1.961 | 30,5 | 1.504 | 23,4 | 1.364 | 21,2 | 1.047 | 16,3 | 6.435 | 100,0 |
| Lipjani | 15.048 | 32,7 | 10.787 | 23,4 | 12.722 | 27,6 | 4.255 | 9,2 | 3.217 | 7,0 | 46.030 | 100,0 |
| Novobërda | 1.174 | 23,7 | 2.082 | 42,1 | 846 | 17,1 | 744 | 15,0 | 105 | 2,1 | 4.950 | 100,0 |
| Obiliqi | 4.861 | 27,6 | 5.740 | 32,5 | 3.953 | 22,4 | 2.223 | 12,6 | 864 | 4,9 | 17.642 | 100,0 |
| Rahoveci | 18.725 | 31,8 | 16.820 | 28,6 | 16.019 | 27,2 | 3.936 | 6,7 | 3.384 | 5,7 | 58.883 | 100,0 |
| Peja | 20.247 | 28,3 | 20.661 | 28,8 | 17.598 | 24,6 | 7.674 | 10,7 | 5.460 | 7,6 | 71.640 | 100,0 |
| Podujeva | 23.785 | 28,6 | 24.208 | 29,1 | 20.903 | 25,1 | 8.741 | 10,5 | 5.547 | 6,7 | 83.185 | 100,0 |
| Prishtina | 12.302 | 23,2 | 14.988 | 28,3 | 15.526 | 29,3 | 7.020 | 13,2 | 3.173 | 6,0 | 53.010 | 100,0 |
| Prizreni | 21.639 | 30,8 | 20.248 | 28,8 | 18.356 | 26,1 | 5.675 | 8,1 | 4.396 | 6,3 | 70.312 | 100,0 |
| Skenderaj | 20.384 | 28,1 | 23.574 | 32,5 | 17.286 | 23,8 | 7.156 | 9,9 | 4.111 | 5,7 | 72.510 | 100,0 |
| Shtimja | 8.531 | 33,2 | 6.700 | 26,1 | 6.603 | 25,7 | 2.319 | 9,0 | 1.555 | 6,1 | 25.708 | 100,0 |
| Shtërpca | 783 | 15,0 | 1.371 | 26,2 | 1.316 | 25,1 | 1.233 | 23,6 | 531 | 10,1 | 5.234 | 100,0 |
| Suhareka | 19.498 | 29,6 | 19.308 | 29,3 | 17.507 | 26,6 | 6.999 | 10,6 | 2.528 | 3,8 | 65.840 | 100,0 |
| Ferizaji | 19.056 | 28,8 | 18.707 | 28,3 | 17.171 | 26,0 | 7.105 | 10,8 | 4.036 | 6,1 | 66.075 | 100,0 |
| Vitia | 16.646 | 32,4 | 13.288 | 25,9 | 13.146 | 25,6 | 4.703 | 9,2 | 3.563 | 6,9 | 51.347 | 100,0 |
| Vushtrria | 17.776 | 26,9 | 20.288 | 30,7 | 16.515 | 25,0 | 7.721 | 11,7 | 3.835 | 5,8 | 66.135 | 100,0 |
| Z.Potoku | 310 | 7,7 | 1.036 | 25,6 | 894 | 22,1 | 762 | 18,9 | 1.037 | 25,7 | 4.038 | 100,0 |
| Zveçani | 1.143 | 19,6 | 940 | 16,2 | 1.568 | 27,0 | 635 | 10,9 | 1.531 | 26,3 | 5.817 | 100,0 |
| Malisheva | 13.820 | 29,9 | 15.885 | 34,4 | 9.896 | 21,4 | 4.917 | 10,6 | 1.687 | 3,7 | 46.205 | 100,0 |

**Tabela 2.4: Struktura gjinore e popullsisë bujqësore sipas rajoneve**

| Rajonet | Meshkuj | | Femra | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| **Kosova** | 696.330 | 52,6 | 628.162 | 47,4 | 1.324.492 | 100,0 |
| Prishtina | 176.296 | 52,7 | 158.499 | 47,3 | 334.795 | 100,0 |
| Mitrovica | 101.145 | 53,1 | 89.399 | 46,9 | 190.545 | 100,0 |
| Peja | 78.026 | 52,1 | 71.643 | 47,9 | 149.668 | 100,0 |
| Gjakova | 80.055 | 52,9 | 71.270 | 47,1 | 151.324 | 100,0 |
| Prizreni | 113.978 | 52,7 | 102.441 | 47,3 | 216.419 | 100,0 |
| Ferizaji | 65.895 | 52,7 | 59.164 | 47,3 | 125.059 | 100,0 |
| Gjilani | 80.935 | 51,7 | 75.746 | 48,3 | 156.682 | 100,0 |

Rezultatet e anketës tregojnë përqindje më të lartë të meshkujve 53.1 për qind në rajonin e Mitrovicës, në rajonin e Gjakovës 52.9 dhe Prizrenit 52.7 për qind. Dominimi i meshkujve në popullsinë bujqësore gjithashtu është treguar edhe në anketat e vitit 2004, 2005 dhe 2006.

Në anketë, të dhënat janë grumbulluar edhe për nivelin arsimor. Tabela 2.5 paraqet nivelin e arsimimit të popullsisë bujqësore sipas grup-moshave.

**Tabela 2.5: Arsimimi i popullsisë bujqësore sipas grup-moshave (nga 15-64 vjeçare)**

| Niveli i edukimit | Grup-mosha | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 15 - 29 vjeçare | | 30 - 49 vjeçare | | 50 - 64 vjeçare | | Gjithsej | |
| | Numri | % | Numri | % | Numri | % | Numri | % |
| Pa shkollë | 3.676 | 1,0 | 8.383 | 2,5 | 13.753 | 10,1 | 25.811 | 3,0 |
| Shkolla fillore jo e kryer | 30.014 | 7,8 | 11.571 | 3,4 | 22.426 | 16,5 | 64.011 | 7,5 |
| Shkolla fillore e kryer | 103.110 | 26,8 | 133.865 | 39,7 | 54.784 | 40,3 | 291.759 | 34,0 |
| Shkolla e mesme jo e kryer | 74.243 | 19,3 | 5.589 | 1,7 | 2.224 | 1,6 | 82.057 | 9,6 |
| Shkolla e mesme e kryer | 132.894 | 34,6 | 148.209 | 44,0 | 29.975 | 22,1 | 311.078 | 36,3 |
| Shkolla e lartë jo e kryer | 1.960 | 0,5 | 1.755 | 0,5 | 734 | 0,5 | 4.449 | 0,5 |
| Shkolla e lartë e kryer | 2.491 | 0,6 | 8.229 | 2,4 | 5.629 | 4,1 | 16.349 | 1,9 |
| Fakulteti jo i kryer | 28.037 | 7,3 | 5.965 | 1,8 | 1.493 | 1,1 | 35.495 | 4,1 |
| Fakulteti i kryer | 7.942 | 2,1 | 13.288 | 3,9 | 4.901 | 3,6 | 26.130 | 3,0 |
| Gjithsej | 384.366 | 100,0 | 336.855 | 100,0 | 135.919 | 100,0 | 857.140 | 100,0 |

Pjesa më e madhe e popullsisë bujqësore ka arsimim fillor ose të mesëm. Pjesa e këtyre dy grupeve së bashku zë 70.3 për qind e popullsisë bujqësore të rritur, dhe të moshës aktive të punës. Në të dy ekstremet, pa arsimim dhe me arsimim terciar, pjesa e popullsisë është e vogël: pa arsimim 3.0 për qind dhe me arsimim të kryer të lartë 3.0 për qind.

`

# 3. Shfrytëzimi i tokës dhe struktura e fermës

Anketa e ekonomive shtëpiake bujqësore 2007 grumbulloi të dhëna rreth ekonomive shtëpiake bujqësore, rreth shfrytëzimit të çdo ngastre të tokës, pronë e vetja ose e marrë për punë, përfshirë edhe tokën e lënë djerrinë. Siç është shpjeguar në kapitullin 1, ajo gjithashtu grumbulloi të dhënat për ngastrat që fizikisht gjenden brenda pronës së ekonomisë shtëpiake të intervistuar por që janë dhënë me qira ose të dhëna pa pagesë të tjerëve për ta punuar. Këto ngastra mbulojnë sipërfaqe të vogla të tokës, 2908 ha. Në tabelat e mëposhtme, kjo sipërfaqe është përfshirë në kategorinë 'tjetër'. Është menduar se është e domosdoshme që të përfshihen këto ngastra me qëllim të llogaritjes gjithëpërfshirëse për tërë tokën e shfrytëzuar nga ekonomia shtëpiake bujqësore.

**Tabela 3.1: Shfrytëzimi total i tokës brenda sektorit të ekonomive shtëpiake bujqësore**

| Shfrytëzimi i tokës | Sip. (ha) | % |
|---|---|---|
| 1 Ara dhe kopshte | 133.514 | 37,8 |
| 2 Pemishte | 4.277 | 1,2 |
| 3 Vreshta | 844 | 0,2 |
| 4 Serra | 251 | 0,1 |
| 5 Livadhe | 95.218 | 27,0 |
| *Gjithsej tokë e kultivuar* | 234.105 | 66,3 |
| 6 Kullosa | 3.796 | 1,1 |
| 7 Djerrina | 21.970 | 6,2 |
| *Gjithsej tokë bujqësore* | *259.871* | *73,6* |
| 8 Male | 76.171 | 21,6 |
| 9 Oborre shtëpish | 13.029 | 3,7 |
| 10 Të tjera | 4.008 | 1,1 |
| Gjithsej | 353.079 | 100,0 |

Toka bujqësore në pronësi ose që shfrytëzohet nga ekonomitë shtëpiake, zë rreth 73.6 % të sipërfaqes totale të ekonomive shtëpiake bujqësore. Pjesa e mbetur është me pyje dhe oborre shtëpish.

Toka bujqësore përfshinë: arat, kopshtet, serrat, pemishtet, vreshtat, livadhet, kullosat dhe djerrinat (kopshtet janë mbledhur në kategorinë e tokës ara dhe kopshte për thjeshtëzim të grumbullimit të të dhënave).

Shfrytëzimi i tokës sipas kategorive kryesore është paraqitur në grafikun 3.1.

**Grafiku 3.1: Shfrytëzimi i tokës bujqësore**




Ky grafik dallon nga grafiku i njëjtë i vitit 2006. Grafiku i vitit 2007 përfshin shfrytëzimin total të tokës sipas kategorive ndërsa ai i vitit 2006 është paraqitur duke marrur për bazë vetëm (përqindjet) token bujqësore.
Pjesa më e madhe e tokës bujqësore, 38 për qind, është ara dhe kopshte; kategoria e dytë më e madhe përbëhet nga livadhet dhe kullosat. Në bazë të anketës, 6 për qind e tokës bujqësore është lënë djerrinë. Rreth një e treta e fermerëve që kanë lënë tokën djerrinë thonë se këtë e bëjnë për shkak të përfitimit të ultë ekonomik.

**Grafiku 3.2: Arsyet e dhëna nga fermerët për tokën e  lënë djerrinë në përqindje**




Arsyet tjera të rëndësishme të paraqitura nga fermerët janë mungesa e të hyrave, pajisjeve ose fuqisë punëtore në ekonomi shtëpiake.

Tabela 3.2 tregon sipërfaqen totale të tokës së ujitur të paraqitur në hektar sipas rajoneve në përqindje dhe tabela 3.3 paraqet indikatorët e njëjtë sipas komunave.

**Tabela 3.2: Ujitja e tokës së kultivuar sipas rajoneve**

| Rajonet | Sipërfaqja e ujitur (ha) | Sipërfaqja e pa ujitur (ha) | Gjithsej sipërfaqja (ha) |
|---|---|---|---|
| **Kosova** | 39.368,7 | 187.536,4 | 226.905,1 |
| Prishtina | 5.926,4 | 51.058,5 | 56.984,9 |
| Mitrovica | 4.206,7 | 34.140,6 | 38.347,2 |
| Peja | 12.699,5 | 19.387,1 | 32.086,6 |
| Gjakova | 10.694,4 | 16.690,7 | 27.385,0 |
| Prizreni | 2.551,6 | 22.397,8 | 24.949,4 |
| Ferizaji | 2.013,7 | 19.088,4 | 21.102,1 |
| Gjilani | 1.276,4 | 24.773,3 | 26.049,7 |

Ujitja, siç është raportuar nga fermerët, shfrytëzohet në rreth 39.369 ha, që përfaqëson rreth 17 për qind të sipërfaqes totale të kultivuar. Për nga rajoni, pjesa më e madhe e tokës së ujitur është në Pejë dhe Gjakovë.

**Tabela 3.3: Ujitja e tokës së kultivuar sipas komunave**

| Komunat | Sipërfaqja e ujitur (ha) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | E ujitur | E pa ujitur | Gjithsej | Përqindja e sip.së ujitur |
| | Sipërfaqja (ha) | Sipërfaqja (ha) | Sipërfaqja (ha) | |
| **Kosova** | 39.369 | 187.536 | 226.905 | 17,4 |
| Deçani | 3.865 | 3.922 | 7.786 | 49,6 |
| Gjakova | 2.995 | 7.080 | 10.075 | 29,7 |
| Gllogovci | 1.547 | 15.619 | 17.166 | 9,0 |
| Gjilani | 458 | 9.537 | 9.995 | 4,6 |
| Dragashi | 643 | 5.214 | 5.856 | 11,0 |
| Istogu | 2.793 | 6.218 | 9.011 | 31,0 |
| Kaçaniku | 224 | 3.590 | 3.814 | 5,9 |
| Klina | 1.820 | 6.499 | 8.319 | 21,9 |
| F. Kosova | 396 | 5.585 | 5.981 | 6,6 |
| Kamenica | 499 | 7.382 | 7.882 | 6,3 |
| Mitrovica | 1.214 | 5.181 | 6.395 | 19,0 |
| Leposaviqi | 30 | 680 | 709 | 4,2 |
| Lipjani | 971 | 6.164 | 7.135 | 13,6 |
| Novobërda | 237 | 1.253 | 1.490 | 15,9 |
| Obiliqi | 573 | 3.232 | 3.805 | 15,1 |
| Rahoveci | 3.835 | 5.689 | 9.524 | 40,3 |
| Peja | 8.087 | 6.670 | 14.757 | 54,8 |
| Podujeva | 1.493 | 11.650 | 13.142 | 11,4 |
| Prishtina | 710 | 7.557 | 8.267 | 8,6 |
| Prizreni | 958 | 4.675 | 5.633 | 17,0 |
| Skenderaj | 189 | 14.360 | 14.549 | 1,3 |
| Shtimja | 502 | 4.113 | 4.614 | 10,9 |
| Shtërpca | 532 | 636 | 1.168 | 45,5 |
| Suhareka | 836 | 6.738 | 7.574 | 11,0 |
| Ferizaji | 756 | 10.750 | 11.506 | 6,6 |
| Vitia | 319 | 7.854 | 8.173 | 3,9 |
| Vushtrria | 2.514 | 11.566 | 14.080 | 17,9 |
| Z. Potoku | 86 | 1.727 | 1.813 | 4,8 |
| Zveçani | 174 | 627 | 801 | 21,8 |
| Malisheva | 115 | 5.771 | 5.886 | 1,9 |

Sipas komunave, pjesa më e madhe e sipërfaqes së ujitur është në Pejë, Deçan, Rahovec, Gjakovë dhe Istog.

### Tabela 3.4: Toka bujqësore sipas madhësisë dhe strukturës së fermës

| Madhësia e fermës | Fermat e vogla | | | Fermat e mëdha dhe të specializuara | | | Gjithsej | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. i fermave | Sip.(ha) | % e fermave | Nr. i fermave | Sip.(ha) | % e fermave | Nr. i fermave | Sip.(ha) | % e fermave |
| 0,05 – 0,5 ha | 37.457 | 11.755,9 | 20,4 | 4 | 1,3 | 3,8 | 37.461 | 11.757,2 | 20,4 |
| 0,51 – 1 ha | 51.480 | 39.636,8 | 28,1 | 2 | 1,4 | 1,9 | 51.482 | 39.638,2 | 28,1 |
| 1,01 – 1,5 ha | 43.135 | 53.522,2 | 23,5 | 2 | 2,8 | 1,9 | 43.137 | 53.525,0 | 23,5 |
| 1,51 – 2 ha | 15.530 | 27.283,9 | 8,5 | 5 | 8,9 | 4,8 | 15.535 | 27.292,8 | 8,5 |
| 2,01 – 3 ha | 20.043 | 48.921,3 | 10,9 | 10 | 26,1 | 9,6 | 20.053 | 48.947,4 | 10,9 |
| 3,01 – 4 ha | 7.144 | 24.357,8 | 3,9 | 2 | 6,1 | 1,9 | 7.146 | 24.363,9 | 3,9 |
| 4,01 – 5 ha | 3.175 | 14.059,9 | 1,7 | 10 | 44,6 | 9,6 | 3.185 | 14.104,5 | 1,7 |
| 5,01 – 6 ha | 2.024 | 11.027,3 | 1,1 | 5 | 27,1 | 4,8 | 2.029 | 11.054,4 | 1,1 |
| 6,01 – 8 ha | 1.967 | 13.412,1 | 1,1 | 9 | 64,2 | 8,7 | 1.976 | 13.476,2 | 1,1 |
| 8,01 – 10 ha | 531 | 4.697,3 | 0,3 | 10 | 92,4 | 9,6 | 541 | 4.789,7 | 0,3 |
| Mbi 10 ha | 696 | 10.419,0 | 0,4 | 45 | 3159,0 | 43,3 | 741 | 13.578,1 | 0,4 |
| Gjithsej | 183.182 | 259.093,5 | 100 | 104 | 3434,0 | 100 | 183.286 | 262.527,5 | 100 |

Tabela 3.4 tregon shpërndarjen e fermave për nga madhësia. Fermat klasifikohen në 11 grupe në bazë të sipërfaqes së tokës së tyre bujqësore.

Duke marrë në konsideratë të gjithë fermerët së bashku, Grafiku 3.3 tregon se 28.1 për qind e tokës bujqësore, është nën fermat në mes 05 - 1 ha. Mesatarja e tokës bujqësore për ekonomi shtëpiake bujqësore është 1.43 ha. Struktura shumë e fragmentuar e fermës pengon zhvillimin e bujqësisë komerciale dhe çon kah prodhimi jo-komercial.

### Grafiku 3.3: Shpërndarja e tokës bujqësore në grupet e ndryshme të madhësive të fermave



### Tabela 3.5: Grupet sipas madhësisë së fermës dhe struktura e fermës sipas rajoneve

| Rajonet | Fermat e vogla | | | | | | Fermat e mëdha dhe të specializuara | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 - 1.5 ha | | 1.51 - 3 ha | | 3.01 + ha | | | | | |
| | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % |
| **Kosova** | 102.772 | 100,0 | 76.514 | 100,0 | 79.807 | 100,0 | 3434 | 100,0 | 262.527 | 100,0 |
| Prishtina | 24.446 | 23,9 | 21.716 | 28,1 | 21.704 | 29,9 | 1393 | 11,5 | 69.259 | 25,3 |
| Mitrovica | 14.190 | 14,0 | 14.988 | 19,8 | 13.906 | 16,9 | 229 | 8,7 | 43.314 | 15,4 |
| Peja | 11.042 | 10,6 | 10.674 | 13,9 | 12.149 | 13,8 | 1000 | 26,0 | 34.866 | 11,5 |
| Gjakova | 10.618 | 9,6 | 9.738 | 12,7 | 9.930 | 11,7 | 244 | 10,6 | 30.530 | 10,4 |
| Prizreni | 16.824 | 17,8 | 2.871 | 3,7 | 7.618 | 9,3 | 360 | 27,9 | 27.673 | 14,2 |
| Ferizaji | 11.284 | 10,3 | 6.153 | 8,1 | 5.391 | 5,6 | 102 | 3,8 | 22.931 | 9,5 |
| Gjilani | 14.368 | 13,7 | 10.375 | 13,7 | 9.108 | 12,8 | 105 | 11,5 | 33.956 | 13,6 |

### Tabela 3.6: Sipërfaqja e përgjithshme e tokës sipas shfrytëzueshmerisë dhe strukturës së fermës

| Shfrytëzimi i tokës | Fermat e vogla | | | | | | Fermat e mëdha dhe të specializuara | | Gjithsej | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 0 - 1.5 ha | | 1.51 - 3 ha | | 3.01 + ha | | | | | |
| | Sip. (ha) | % | Sip.(ha) | % | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % | Sip. (ha) | % |
| Ara dhe kopshte | 50.996 | 37,4 | 40.068 | 42,8 | 40.301 | 42,5 | 2.149 | 38,8 | 133.514 | 37,8 |
| Pemishte | 2.259 | 4,0 | 1.075 | 3,5 | 875 | 3,6 | 68 | 4,6 | 4.277 | 1,2 |
| Vreshta | 378 | 0,4 | 203 | 0,3 | 258 | 0,5 | 6 | 1,3 | 844 | 0,2 |
| Serra | 157 | 2,4 | 42 | 2,5 | 50 | 2,1 | 2 | 1,8 | 251 | 0,1 |
| Livadhe | 37.572 | 18,7 | 26.666 | 19,4 | 30.254 | 23,1 | 726 | 30,9 | 95.218 | 27,0 |
| *Gjithsej tokë e kultivuar* | 91.362 | | 68.054 | | 71.737 | | 2.951 | | 234104 | |
| Kullosa | 1.173 | 0,6 | 1.017 | 1,0 | 1.598 | 1,1 | 8 | 0,7 | 3796 | 1,1 |
| Djerrina | 9.227 | 5,2 | 6.255 | 5,3 | 6.012 | 4,8 | 476 | 3,3 | 21970 | 6,2 |
| *Gjithsej tokë bujqësore* | 101.762 | | 75.326 | | 79.347 | | 3.435 | | 259.870 | |
